REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AKADEMIA E SHKENCAVE

KRYESIA

Nr. 357 prot.

# URDHËR

**Nr. 11, datë 6 tetor 2016**

***Për miratimin e Rregullores***

***Për themelimin e çmimeve vjetore shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; për mënyrën e organizimit të konkurseve; për kriteret e zgjedhjes së fituesve dhe mënyrën e shpalljes së tyre***

**Drejtuar :** *Kryesisë së Akademisë së Shkencave (më tej: ASHSH), seksioneve shkencore të ASHSH, anëtarëve të Asamblesë së ASHSH;*

**Për dijeni:** *Sektorit të financës, sektorit të burimeve njerëzore dhe shërbimeve, sektorit të botimeve shkencore dhe bibliotekës shkencore, specialistit të marrëdhënieve me jashtë dhe komunikimeve shkencore, specialistit të IT-së.*

Në mbështetje të Ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, *Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë,* neni 4, pika *dh* dhe neni 13; si dhe referuar praktikës shkresore me Ministrinë e Financave (shkresa nr. prot. 318, datë 07.09.2016 *Për miratimin e dhënies së çmimeve monetare në shkencë, që jep Akademia e Shkencave* dhe shkresa nr. prot. 12054/1, datë 20.09.2016, *Kthim përgjigjje*), me propozim të Sekretarit Shkencor të ASH-së:

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e Rregullores *Për themelimin e çmimeve vjetore shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; për mënyrën e organizimit të konkurseve; për kriteret e zgjedhjes së fituesve dhe mënyrën e shpalljes së tyre,* sipas tekstit bashkëmbyllur.

2. Kjo Rregullore hyn në fuqi  menjëherë.

3. Ngarkohet sekretaria e Kryesisë së ASHSH për shpërndarjen e këtij urdhri.

4. Ngarkohet Sekretari Shkencor i ASHSH për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.

**KRYETARI**
**MUZAFER KORKUTI**